



VROJTIMI I AKTIVITETIT KREDITUES

2

0

1

9

Tremujori i parë

DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

HYRJE¹

Pyetësoni i Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues synon të mbledhë opinionin e bankave tregtare, lidhur me zhvillimet e tre muajve të fundit, në ofertën dhe kërkesën për kredi, si edhe pritjet e tyre për tremujorin e ardhshëm. Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues jep, në mënyrë të përmbledhur, perceptimet e bankave mbi ndryshimet në kushtet e ofertës për kredi, ilustruar nëpërmjet standardeve dhe kushteve e termave të kreditimit, si edhe mbi ndryshimet në kërkesën për kredi, si për bizneset, ashtu edhe individët. Kjo analizë bazohet në rezultatet e agreguara nga përgjigjet e dhjetë bankave me peshën më të madhe të stokut të kredisë së dhënë për sektorin privat.

¹ Pyetësoni i Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues është rishikuar në tremujorin e dytë të vitit 2018, me qëllim përafrimin e tij të mëtejshëm me praktikën më të fundit ndërkombëtare, sidomos me atë të Bankës Qendrore Evropiane. Për pasojë, dhe analiza e lidhur me të është përshtatur me pyetësonin e ri. Ajo është pasuruar në terma të pyetjeve shtesë, si edhe specifikimeve lidhur me faktorët që ndikojnë standardet, kushtet e kreditimit dhe kërkesën për kredi. Duke filluar nga tremujori i katërt i vitit 2018, seritë janë testuar për praninë e sezonalitetit, sipas metodave statistikore të përdorura për këtë qëllim. Seritë që mbartin sezonalitet, sipas specifikimeve të testeve statistikore, janë korrigjuar për këtë efekt dhe kanë zëvendësuar seritë ekzistuese të parregulluara për efektin sezonal në kryerjen e analizës mbi aktivitetin kreditues. Pyetësonin e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues së bashku me fjalorin e termave të përdorur në të, një material të shkurtër mbi rëndësinë e këtij vrojtimi, disa aspekte metodologjike, si edhe seritë e përdorura në analizë, i gjeni të publikuara në adresën:

https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues.

PËRMBLEDHJE

Bazuar në perceptimet e bankave tregtare, standardet e kreditimit për bizneset u shtrënguan disi në tremujorin e parë të vitit 2019, në sajë të shtrëngimit të lehtë të standardeve për kreditë me qëllim investimi dhe ato për likuiditete, e lokalizuar në segmentin e biznesit të madh. Kërkesa për kredi e bizneseve u vlerësua më e ulët, duke qenë më e evidente në segmentin e bizneseve të vogla e të mesme, për të dyja llojet e kredisë, atë për likuiditete dhe atë për investime. Standardet e kreditimit për individët u raportuan disi të shtrënguara, për kreditë me qëllim blerje banese. Kërkesa për kredi e individëve në tremujorin e parë të vitit, sipas gjykimit të bankave, ishte më e ulët si për kreditë për blerje banese, ashtu edhe ato konsumatore.

Në tremujorin e dytë të vitit 2019, bankat presin të aplikojnë standarde kreditimi disi më të lehtësuara për bizneset, ndërkohë që kërkesa për kredi pritet të jetë më e lartë në të dy segmentet. Standardet e kreditimit priten të lehtësohen edhe për individët në tremujorin e dytë të vitit 2019, duke qenë në të njëjtën linjë me pritjet e bankave për një kërkesë të shtuar nga kjo kategori.

STANDARDET, TERMAT E KREDITIMIT DHE KËRKESA PËR KREDI


1. KREDIA PËR BIZNESE

1.1. Standardet e kreditimit

Standardet e kreditimit për biznese, në tremujorin e parë të vitit 2019, u raportuan lehtësisht të shtrënguara nga një tremujor më parë². Shtrëngimi i standardeve u perceptua në segmentin e bizneseve të mëdha, si edhe për të dyja llojet e përdorimit të kredisë, atë për investime dhe për likuiditete. Në segmentin e bizneseve të vogla e të mesme, standardet ishin pak më të lehtësuara se një tremujor më parë.

Bankat u shprehën se presin t'i lehtësojnë disi standardet e kreditimit për bizneset në tremujorin e dytë të vitit 2019, më së shumti në kreditë e destinuar për qëllime likuiditeti dhe në segmentin e biznesit të madh.

Grafik 1. Standardet e kreditimit për bizneset dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm¹




¹: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë lehtësim të standardeve, ndërsa ato negative shtrëngim të standardeve.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

² Standardet e kreditimit u raportuan disi më të shtrënguara se një tremujor më parë vetëm nga një bankë e sistemit.

Në kahun shtrëngues të standardeve të kreditimit për bizneset, në tremujorin e parë, u raportua ndikimi i faktorëve të lidhur me perceptimin e rrezikut nga ana e bankave, të tillë si: aftësia paguese e kredimarrësit, situata ekonomike dhe perspektiva e saj, si edhe rreziqet lidhur me kolateralin; si edhe toleranca e bankës ndaj rrezikut. Në kahun lehtësues të standardeve të kreditimit, veprim kryesisht trysnia nga konkurrenca në sistemin bankar.

Grafik 2. Faktorët me ndikim në standardet e kreditimit për totalin e bizneseve²




²: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve, ndërsa ato negative në shtrëngimin e standardeve. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësonin e rishikuar në qershor 2018.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2. Kushtet dhe termat e kreditimit

Kushtet dhe termat e përgjithshëm mbi kreditë e reja akorduar bizneseve u raportuan të pandryshuara nga një tremujor më parë. Megjithatë, marzhet e aplikuara mbi kreditë normale, si edhe ato me rrezik, u vlerësuan disi më të larta nga një tremujor më parë. Po ashtu, edhe kushtet e tjera joqimim, të lidhura me kërkesën për kolateral në raport me madhësinë e kredisë, reduktimi i madhësisë së kredisë, si edhe kushtëzimet nga marrëveshja e kredisë, vepruan disi në shtrëngimin e kushteve dhe termave të përgjithshëm të kreditimit për bizneset.

Grafik 3. Ndryshimi i kushteve dhe termave të përgjithshëm në miratimin e kredive të reja për bizneset³




³: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë kushte dhe terma të lehtësuara, ndërsa ato negative të shtrënguar.

Burimi: Banka e Shqipërisë. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësonin e rishikuar në qershor 2018.

Kostot dhe kufizimet nga bilanci, si dhe perceptimi i rrezikut, u raportuan si faktorë me ndikim negativ tek kushtet dhe termat mbi kreditë akorduar bizneseve në tremujorin e parë të vitit 2019.

Grafik 4. Faktorët me ndikim në kushtet dhe termat e kreditimit për totalin e bizneseve⁴




⁴: Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e kushteve dhe termave, ndërsa ato negative në shtrëngimin e kushteve dhe termave. *: Ky grafik bazohet mbi një pyetje të re të shtuar në pyetësonin e rishikuar në qershor 2018. Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.3. Kërkesa për kredi

Kërkesa për kredi e bizneseve u perceptua më e ulët në tremujorin e parë të vitit 2019. Ajo u raportua më e ulët si në kreditë për qëllim investimi, ashtu edhe në atë për likuiditete. Parë në prizmin e madhësisë së biznesit, rënia më e theksuar e kërkesës për kredi u vlerësua nga ana e bizneseve të vogla e të mesme.

Grafik 5. Kërkesa aktuale për kredi dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm për bizneset⁵




⁵: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë rritje të kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tremujorin e dytë të vitit 2019, bankat presin një kërkesë të shtuar të bizneseve për kredi. Kërkesa vlerësohet të jetë më e lartë si nga bizneset e mëdha, ashtu edhe nga ato të vogla e të mesme. Po ashtu, bazuar në opinionet e bankave, kërkesa e bizneseve pritet të jetë më e lartë si në kreditë për qëllime likuiditeti, ashtu edhe ato për investime.

Faktorët e perceptuar nga ana e bankave në përcaktimin e një kërkesë më të ulët për kredi të bizneseve në tremujorin e parë të vitit 2019, ishin: rënia e nevojës për financimin e likuiditeteve; përdorimi më i lartë i burimeve të brendshme të financimit nga ana e bizneseve; situata e perceptuar ekonomike dhe

perspektiva e saj; besimi i biznesit; si edhe nevojat më të ulëta për financim nga ana e bizneseve, si pasojë e restrukturimit të kompanive.

Grafik 6. Faktorët që ndikuan në ndryshimin e kërkesës për kredi për bizneset⁶




⁶: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka nxitur rritjen e kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënien e saj. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësorin e rishikuar në qershor 2018. Burimi: Banka e Shqipërisë.

2. KREDIA PËR INDIVIDË

2.1. Standardet e kreditimit

Standardet e kreditimit për individët u raportuan disi më të shtrënguara në tremujorin e parë të vitit 2019. Shtrëngimi i lehtë i standardeve u raportua në kreditë për blerje banese, ndërkohë që standardet në kreditë konsumatore ishin disi më të lehtësuara nga një tremujor më parë. Bankat u shprehën se presin të aplikojnë standarde të lehtësuara kreditimi për individët, në të dyja kategoritë, në tremujorin e dytë të vitit 2019.

Grafik 7. Standardet e kreditimit për individët dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm⁷




⁷: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë lehtësim të standardeve, ndërsa ato negative shtrëngim të standardeve.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Standardet e kreditimit për individët u shtrënguan në sajë të: rritjes së kostove dhe kufizimet e shtuara nga pozicioni kapital i bankës; perceptimit të bankës për rrezik më të lartë të lidhur si me aftësinë paguese të kredimarrësit, ashtu edhe me kolateralin. Nga ana tjetër, në kahun lehtësues të standardeve ndikuan kostot e kufizimet më të ulëta që burojnë nga pozicioni i likuiditetit të bankave, si edhe zhvillimet aktuale dhe perspektiva për tregun e banesave.

Grafik 8. Faktorët me ndikim në standardet e kreditimit për totalin e individëve⁸




⁸: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e standardeve, ndërsa ato negative në shtrëngimin e standardeve. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësinë e rishikuar në qershor 2018. Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2. Kushtet dhe termat e kreditimit

Kushtet dhe termat e përgjithshëm për kreditë akorduar individëve u lehtësuan në tremujorin e parë të vitit, kryesisht në sajë të aplikimit të marzheve më të ulëta mbi kreditë normale, si edhe kërkesës më të ulët për kolateral në raport me madhësinë e kredisë. Në kahun shtrëngues të kushteve dhe termave të kreditimit u raportuan marzhet më të larta të aplikuar mbi kreditë me rrezik, si edhe reduktimi i maturitetit maksimal të kredisë.


Grafik 9. Ndryshimi i kushteve dhe termave të përgjithshëm në miratimin e kredive të reja për individët⁹



⁹: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë kushte dhe terma të lehtësuar, ndërsa ato negative të shtrënguar. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësinë e rishikuar në qershor 2018. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Trysnia nga konkurrenca si dhe kostoja e ulët e fondeve u raportuan si faktorë që vijnë të nxisin lehtësimin e kushteve dhe termave të kreditimit për individët.

Grafik 10. Faktorët me ndikim në kushtet dhe termat e kreditimit për totalin e individëve¹⁰




¹⁰: Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka ndikuar në lehtësimin e kushteve dhe termave, ndërsa ato negative në shtrëngimin e kushteve dhe termave. *: Ky grafik bazohet mbi një pyetje të re të shtuar në pyetësin e rishikuar në qershor 2018. Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.3. Kërkesa për kredi

Kërkesa e individëve për kredi u raportua më e ulët në tremujorin e parë të vitit, kryesisht në sajë të një kërkesë me të reduktuar për kredi konsumatore. Bazuar në opinionin e bankave, kërkesa për kredi e individëve vlerësohet të jetë më e lartë në tremujorin e dytë të vitit 2019, në të dyja kategoritë: atë konsumatore dhe atë për blerje banese.


Grafik 11. Kërkesa aktuale për kredi dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm për individët¹¹



¹¹: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë rritje të kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënie të saj. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas perceptimit të bankave, rënia e kërkesës për kredi në tremujorin e parë nga ana e individëve u shkaktua nga: përdorimi më i lartë i burimeve të brendshme të financimit; kreditë nga bankat dhe institucionet financiare jobanka; besimi konsumator; si edhe zhvillimet aktuale dhe të pritura në tregun e banesave. Në kahun rritës të kërkesës për kredi ka ndikuar nevoja e shtuar për financimin e konsumit.

Grafik 12. Faktorët që ndikuan në ndryshimin e kërkesës për kredi për individët¹²



¹²: Llogariten si përqindje neto. Vlerat pozitive tregojnë se faktori ka nxitur rritjen e kërkesës për kredi, ndërsa ato negative rënieën e saj. *: Tregues i ri i shtuar në pyetësorin e rishikuar në qershor 2018.

Burimi: Banka e Shqipërisë.